

**INSTITUTI I KURRIKULËS DHE STANDARDEVE**

**PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM DHE TË ULËT**

**LËNDA:GJUHA AMTARE**

**(klasa e shtatë)**

**Tiranë, 2006**

## I. TË PËRGJITHSHME

Mësimi i lëndës së **Gjuhës amtare** në klasën VIII, në Nivelin e Mesëm të Ulët të shkollës në Shqipëri do të zhvillohet sipas Strukturës Mësimore aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës 2004. Ai vazhdon për 35 javë mësimore me 5 orë në javë. Gjithsej, 175 orë mësimore do të zhvillohen në klasën VIII. Sasia prej 15 % e kohës mësimore, domethënë (26 orë) i lihet në dispozicion mësuesit. Ato mund të përdoren prej tij ashtu si ai e sheh të arsyeshme, të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor sipas kushteve konkrete të klasës dhe nevojave të nxënësve.

Veçoritë e zhvillimit të lëndës në klasën VIII kanë të bëjnë me vazhdimësinë dhe thellimin në dhënien e njohurive gjuhësore e komunikuese sipas parimeve specifike të organizimit të strukturës e të përmbajtjes së saj. Mësimi i gjuhës shqipe përbën në të vërtetë lëndën bazë në sistemin tonë të edukimit parauniversitar. Ai është vlerësuar me të drejtë si momenti kyç i tërë suksesit dhe i progresit të nxënësve. Nëpërmjet tij hidhen bazat për ruajtjen e shëndetit mendor të fëmijës, dhe ndër vite materializojnë zhvillimin intelektual, emocional e shoqëror të nxënësit,

- duke bërë të mundur realizimin e komunikimit me qëllime të ndryshme,
- duke paraqitur përvojat, ndjenjat dhe idetë e tyre dhe të tjerëve,
- duke i dhënë veshje kuptimore procesit të menduarit.

Gjuha që mësojnë dhe fitojnë nxënësit në shkollë siç dihet, është pasqyrë e formimit si individ dhe karakteristikë e të folurit të tyre. Nxitja për të pasuruar përvojat gjuhësore, për t'i bërë ato më të pasura, më të këndshme dhe më të larmishme është detyrë me rëndësi e shkollës dhe e mësuesit.

Në vështrim të përgjithshëm, shkolla jonë ka për detyrë të mbështetë nxënësit në mësimin e gjuhës amtare shqipe, në formën e vet standarde. Kështu, nëpërmjet zhvillimit të lëndës së gjuhës shqipe zhvillohen dhe arrihen dy objektiva të rëndësishëm mësimorë:

*1. Të zhvillohen shprehjet komunikuese, të cilat realizojnë në tërësi aktin e komunikimit:*

- të dëgjuarit,
- të folurit,
- të lexuarit
- të shkruarit.

*2. Të ngulisë dhe të sistemojë njohuri të caktuara për gjuhën shqipe,*

- sistemin e saj gjuhësor,
- normën standarde të saj

*për të cilat nxënësi të jetë i vetëdijshëm.*

Ky program është hartuar në përputhje me kërkesat bashkëkohore në fushën kurrikulare për një Shoqëri të Hapur, ku mësuesi dhe nxënësi jo vetëm të bashkëpunojnë në procesin e ndryshimit, por ndihen, autorë dhe aktorë të rëndësishëm në këto hapa ndryshimi. Këto kërkesa të ditës do të realizohen përmes nisjes nga parime të tilla si ai:

- Parimit koncentrik
- Parimit integruar.

Janë pikërisht këto parime, të cilat arrijnë të krijojnë disa hapësira si dhe mundësi konkrete për risi të mirëfillta në zërvendimin dhe sendërtimin e këtij programi në praktikën e përditshme mësimore. Në kl VIII njohuritë gjuhësore dhe kthimi i tyre në shprehje do të kalojë përmes një strategjie të re, e cila konsiston në kërkimin dhe gjetjen e teknikave bashkëkohore për të realizuar dhënien, asimilimin dhe praktikimin e komponentëve si më poshtë:

- aftësi komunikuese me gojë dhe me shkrim
- njohuri për sistemin gjuhësor të shqipes
- qëndrime vlerësuese e vetvlerësuese

me qëllim që nxënësi përmes gjuhës amtare të mund të shprehë nocione, të formatojë koncepte, të transmetojë mesazhe, të cilat për të, janë çelësa në shërbim të vetvetes dhe më gjerë në mjedisin ku jeton. Gjuha amtare është KODI i parë, sistemi i shenjave dhe i rregullave gjuhësore që i shërbejnë nxënësit të ndërtojë komunikim të saktë. Përmes saj nxënësi do të mundë të realizojë marrëdhënie bashkëpunuese për nevoja vetjake dhe më gjerë. Janë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që ai mban ndaj këtij sistemi shenjash dhe rregullash gjuhësore, ato që e bëjnë të arrijë të komunikojë saktë, të njohë suksesin në shoqëri.

- Të mund të marrë njohuri,
- të mund të shprehë mendimet,
- të japë opinione duke argumentuar pozicionimin e tij,
- të mbajë qëndrime e mbi to të marrë vendime,

jo vetëm në lëndën e gjuhës amtare, por në të gjitha lëndët që zhvillohen në klasë.

Parim po aq i rëndësishëm, i cili do të riorganizojë tërë strukturën dhe përmbajtjen e mësimin të lëndës së gjuhës amtare është ai i integritit të gjuhës shqipe me leximin letrar. Ky integrim gjallon për vetë natyrën e ekzistencës së letërsisë si art i fjalës, në saje të gjuhës. Në këtë linjë do të ecet duke ndjekur në mënyrë krijuese shembujt e kurrikulave simotra në studimin e gjuhëve amtare të një sërë vendesh evropiane, të cilat e konsiderojnë dhe e trajtojnë gjuhën amtare, një ndërlëndë. Pra, përmes këtij shtrati gjuhësor ku nxënësi mëson të lexojë tekste të llojeve të ndryshme, nga fusha të ndryshme të jetës duke e përgatitur të njohë jetën në plotësinë e saj dhe, për pasojë, të dijë të ndërtojë sjellje dhe marrëdhënie të drejta, të cilat e ndihmojnë t'i përgjigjet dhe të fitojë mbi sfidat e jetës. Kjo përkthehet në programin e ri për kl VIII me mundësi dhe hapësira të tilla ku, 60% e pjesëve për lexim janë marrë nga materialet joletrare dhe temave nga letërsia artistike i është lënë 40%. Po në këtë linjë, raporti i orëve që trajtojnë shprehitë komunikuese me ato të njohurive gjuhësore është ngritur në favor të shprehive komunikuese 70% me 30%. Ky raport, orienton dhe nxit të mësuarit e integruar duke i ndihmuar nxënësit të gjejnë shpejt dhe me lehtësi informacionin që u duhe jo vetëm në lëndën e gjuhës amtare, por edhe në disiplina të tjera kurrikulare apo ekstrakurrikulare, si edhe ta përpunojnë atë;

- duke zbatuar aftësitë e fituara,
- duke i nxitur të mbajnë qëndrim
- duke i pozicionuar e lënë të lirë, të marrin vendime për probleme të ndryshme në situata të caktuara, të njohura ose jo, në shkollë dhe jashtë saj.

Nga zbatimi i këtij parimi integruar në kuadër ndërlëndor në kl VIII synohet të arrihet një nga qëllimet e strategjisë së re të arsimit shqiptar, **Aftësimi i nxënësit për jetën, arritje** që formon tek nxënësit tanë qytetarët me formim shumëdimensional.

## II . SYNIMET E LËNDËS

Programi i gjuhës amtare për kl VIII dhe zbatimi i tij zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e marra në klasat VI, VII dhe forcojnë bazën mbi të cilën ndërtohet mësimi i kësaj lënde jo vetëm gjatë periudhës shkollore, por edhe më tej gjatë gjithë jetës

Nga vetë emërtimi **Gjuhë amtare dhe objekti i saj si lëndë parësore e me karakter kombëtar, kjo lëndë synon:**

1. Të mundësojë formimin dhe zhvillimin vetjak intelektual, emocional, shoqëror, estetik dhe moral të çdo nxënësi.

2. Të përvetësojnë gjuhën amtare në atë nivel e cilësi që të mundësojë të mësuarit e tyre të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës.

3. Të aftësojnë nxënësit të realizojë komunikimin me shkrim dhe me gojë për nevoja vetjake saktë dhe me kulturë gjuhësore

### **III. LINJAT DHE NËNLINJAT E PËRMBAJTJES**

#### **1. Të dëgjuarit & Të folurit**

- \* Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime në mënyrë individuale dhe në grup.
- \* Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik me shumëllojshmëri qëllimesh.
- \* Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.
- \* Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare.
- \* Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde.

#### **2. Të lexuarit**

- \* Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion.
- \* Të lexuarit për dëshirë që të zgjerojë e të pasurojë horizontin e dijeve nga fusha të ndryshme të shkencës, botës dhe mjedisin që e rrethon.
- \* Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate, që të zgjerojë e të pasurojë botën e tij shpirtërore.
- \* Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare.
- \* Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare, të njohë ndarjet dhe nën ndarjet kryesore të letërsisë nga ana formale dhe përmbajtësore.
- \* Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje.
- \* Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.

#### **3. Të shkruarit**

- \* Të shkruarit funksional duke kuptuar vlerat e shkrimit si element komunikimi.
- \* Të shkruarit për nevoja vetjake, të përdorë atë për shumëllojshmëri qëllimesh.
- \* Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë, të shkruajë në mënyrë të strukturuar.
- \* Të shkruajë për një numër lexuesish duke praktikuar njohuritë e tij rreth gjuhës standarde.

#### **4. Njohuri rreth sistemit të gjuhës**

- \* Sintaksë
- \* Morfologji
- \* Leksikologji
- \* Kulturë gjuhe
- \* Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim.

**IV. KONCEPTET KRYESORE SIPAS NËNLINJAVE, OBJEKTIVA SPECIFIKË DHE REZULTATET E PRITSHME**  
(35 javë mësimi me 5 orë mësimi në javë = 175 orë gjithsej)

**LINJA 1: Të dëgjuarit dhe të folurit**

| Nënlinjat   | Objektivat   | Përmbajtja  |
|---|--|---|
| 1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përcjellë vlerësime rreth ngjarjeve e shëmbujve e të dhënave</li> <li>• Të ndjekë me vëmendje bashkëbiseduesin ose informacionin që vjen nga burime të ndryshme: internet, kasetë , CD, DVD, diapozitiva etj.</li> <li>• Të zhvillojë të menduariit nëpërmjet analizës së faktit e dukurive.</li> <li>• Të përdorë përpunimin e njëkohshëm të të dhënave</li> <li>• Të vendosë lidhje të qëndrueshme me aftësitë e fituara më parë.</li> <li>• Të japë udhëzime dhe orientime; të shpjegojë e të përshkruajë.</li> <li>• Të plotësojë këshillat e të tjerëve duke i pasuruar e pasqyruar në rezultatet e punës.</li> <li>• Të përdorë informacionin e marrë duke vlerësuar aftësite vetjake të fituara.</li> <li>• Të synojë lidhje të forta semiotike qëndrueshme me kujtesën afat gjatë</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punohen materiale të ndryshme që ngrejnë situata dhe çështje aktuale shoqërore, me shembuj konkretë, jetësore dhe reale që japin informacion e nxisin debatin.</li> <li>• Materiale të fushave të ndryshme me të cilat nxënësit duhet të bëjnë analizën dhe sintezën e fakteve dhe të dukurive</li> <li>• Materiale si: një hartë orientuese ose guidë për të gjetur ose për të drejtuar të tjerët për objekte të rëndësishme kulturore, vende turistike, mjedise publike etj.</li> <li>• Tema të mundshme orientimi në treg, stacionin e trenit, në aeroport, në mjedise publike, sportive, ekspozita, biblioteka, koncerte etj.</li> </ul> |
| 2. . Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përshtasë të folurit e vet për situata reale komunikimi në grup.</li> <li>• Të nxitet për të dëgjuar situata të ndryshme ku i duhet të</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punohen materiale të ndryshme nga veprimtaria e përditshme ose tema të tjera që kërkojnë nga nxënësit përdorimin e rregjistrave ndryshëm të gjuhës.</li> </ul>   |

|  |  |  |
|--|--|--|
|  | <p>vlerësojë të folurit e shokut dhe të vetin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përfshihet në lojra me role.</li> <li>• Të zhvillojë të folurin dhe të degjuarin në grupmoshë në mënyrë miqësore.</li> <li>• Të pasurojë linjën e debatit me argumente duke respektuar etikën.</li> <li>• Të paraqitet në mjedise të ndryshme</li> <li>• Të debatojë me argumente pro dhe kundra një teme, e cila është me interes për ta.</li> <li>• Të shfaqë dhe të realizojë larmi formash të të folurit për kontekste të ndryshme</li> <li>• Të dëgjojë të kuptojë dhe të përgjigjet me saktësi .</li> <li>• Të flasë në grup duke mbajtur qëndrim dhe komentuar faktet.</li> <li>• Të respektojë të dhënat e diskutimit në grup.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Materiale të struktururara nga paraqitja, situata, dramatike, komike, etj që plotësohen dhe përpunohen nga nxënësit</li> <li>• Materiale që nxisin interpretimin në role, krijojnë situata debati, problemore, që kërkojnë vëmendje për analizë.</li> <li>• Materiale të ndryshme që propozojnë vetë nxënësit.</li> </ul>   |
| <p>3. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shprehë përvoja vetjake për probleme të ndryshme.</li> <li>• Të shfaqë mendime rreth përvojave të shprehura prej të tjerëve.</li> <li>• Të debatojë me argumente rreth informacioneve të dëgjuara ose të lexuara.</li> <li>• Të tregojë dhe të pyesë për detaje shtesë.</li> <li>• Të tregojë përvojën e tij në mënyrë të strukturuar.</li> <li>• Të organizojë diskutimin duke i vendosur idetë qartë dhe kuptueshëm.</li> <li>• Të përdorin pyetjet: <i>Kush?, kur?, ku?, si?, sa?</i> kur dikutojnë për t'u bërë më bashkëpunues në grup.</li> <li>• Të bëjë hyrje, zhvillime, mbyllje të përvojave që tregojnë.</li> <li>• Të ndihmojë në situata të ndryshme për zgjidhje konflikti.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Materiale informative të marra nga burime të ndryshme; si TV, radio, gazeta, revista, interneti që lejojnë të folurit dhe qëndrimet të pavarura të nxënësve ndaj informacionit të marrë.</li> <li>• Tekste të ndryshme joletrare për të vlerësuar       <ol style="list-style-type: none"> <li>1. situata të ndryshme,</li> <li>2. stilin e autorit</li> <li>3. karakterin e dobishëm e informacioni të tillë,</li> <li>4. gjuhën e përshtatshme me të cilën vjen.</li> </ol> </li> <li>• Materiale me informacione të ndryshme që mundësojnë operacione analizuese dhe konkluduese mbi informacionin e marrë.</li> </ul> |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>4. Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare</p>     | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përcaktojë në tekste të ndryshme letrare elemente formalë dhe gjuhësorë që i dallojnë nga llojet e tjera me të njëjtën fabul.</li> <li>• Të njohin, të analizojnë dhe të vlerësojnë strukturat dhe tipat e ndryshëm të teksteve dramatikë             <ol style="list-style-type: none"> <li>1. në monolog</li> <li>2. në dialogë</li> <li>3. në materialin didaskalik (shënimet autoriale )</li> </ol> </li> <li>• Të dallojë fjalët me ngjyrim emocional pozitiv për t'i bërë ato pjesë të fjalorit vetjak.</li> <li>• Të dallojë llojet e ndryshme letrare të lexuara me elemente të përafërt</li> <li>• Të krahasojë elementet gjuhësorë dhe ndryshimet midis llojeve.</li> <li>• Të zhvillojë aftësitë shprehëse për veprat e gjinisë dramatike.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste dramatike të llojeve të ndryshme (dramë, tragjedi, komedi) për të bërë krahasime dhe vlerësuar materialin gjuhësor             <ol style="list-style-type: none"> <li>1. në monolog</li> <li>2. në dialogë</li> <li>3. në materialin didaskalik (shënimet autoriale )</li> </ol> </li> <li>• Skenarët me disa linja subjekti për të përshkruar skenografinë dhe kostumografinë.             <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste me poezi, prozë poetike, monolog, dramë, reportazh, ese për të bërë vlerësimin krahasues për gjuhën dhe llojin.                 <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste të ndryshme letrare për të analizuar struktura dhe tregues formalë gjuhësorë sipas llojit të tekstit.</li> <li>• Tekste të ndryshme të gjinive dramatike për zhvillimin e shprehive komunikative</li> </ul> </li> </ul> </li> </ul> |
| <p>5. Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde shqipe</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të diskutojë rreth pasurisë në fjalë e forma gramatikore të gjuhës shqipe.</li> <li>• Të dallojë përdorimin e saktë dhe të gabuar në tekste letrare dhe jo letrare.</li> <li>• Të mbajë qëndrim ndaj përdorimeve pavend që dëmtojnë gjuhën amtare.</li> <li>• Të provojë në praktikë përdorimin e gjuhës standarde</li> <li>• Të diskutojë rreth standardeve të gjuhës shqipe</li> <li>• Të vlerësojë gjuhën e teksteve joletrare dhe letrare.</li> <li>•</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Materiale letrare dhe joletrare me përdorime pavend të fjalëve të huaja dhe strukturës sintaksore shqipe.             <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste letrare dhe jo letrare me përdorim të saktë leksiko-gramatikor.</li> </ul> </li> </ul> <p>Krahasime dhe vlerësime përmes materialit që është shkruar jo saktë dhe atij të shkruar sipas gjuhës standarde..</p>   |

## LINJA 2: Të lexuarit

| Nënlinjat  | Objektivat  | Përmbajtja   |
|--|---|--|
| <p>1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion.</p>            | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë duke treguar interes për të marrë informacionin dhe duke e shpjeguar atë përmes fjalëve të tekstit ose të tijat.</li> <li>• Të lexojë për të bërë krahasime midis burimeve të ndryshme të informacionit.</li> <li>• Të përzgjedhë pjesë e materiale që mund të lexohen për nevojat e veta.</li> <li>• Të bëjë lexim të vetëdijshëm për të marrë informacion dhe për ta shpjeguar atë.</li> <li>• Të dallojë mesazhet që dalin nga tekstet e ndryshme.</li> <li>• Të dallojë atë që i intereson midis fakteve dhe opinioneve.</li> <li>• Të lexojë duke respektuar shenjat e pikësimit sipas llojit të tekstit etj.</li> <li>• Të vlerësojë tekstet e tipit joformal.</li> <li>•</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Materiale nga enciklopedi, revista shkencore dhe interneti për të përzgjedhur informacionin e duhur.</li> <li>• Materiale të ndryshme informative që japin dhe forma të ndryshme komunikimi (shëndetësi, sport, kod rrugor, psikologji, filozofi, katalog, indeks, turizëm, arkeologji etj)</li> </ul>  |
| <p>2. Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë në mënyrë artistike dhe me ndjenjë.</li> <li>• Të zbulojë thelbin e teksteve të ndryshme.</li> <li>• Të lexojë duke e përzgjedhur materialin sipas interesave dhe dëshirave të veta.</li> <li>• Të zbërthejë me imagjinatë domethënien e teksteve të ndryshme.</li> <li>• Të përzgjedhë lexime që përmbushin interesat e veta.</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste të llojit letrar të niveleve cilësore, përfaqësuese të letërsisë shqiptare dhe botërore të kohërave të ndryshme.</li> <li>• Poezi, prozë dramë.</li> <li>• Biografi dhe monografi të shkrimtarëve të njohur, njerëzve të shquar në fusha të ndryshme të jetës të pëlqyera nga nxënësit.</li> <li>• Tektse nga gjini të gjata letrare: novela, romani, me personazhe kryesore të pëlqyera nga nxënësit .</li> </ul> |



|   |   |   |
|---|---|---|
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë për të zhvilluar imagjinatën, guximn për të provuar.</li> <li>• Të rrecitojë dhe të interpretojë para grupeve të vogla dhe të medha.</li> <li>• Të njihet me jetën, veprimtarinë letrare dhe joletrare të autorëve.</li> <li>• Të lexojë në mënyrë interpretative dhe me ndjenjë.</li> <li>•</li> </ul>  |   |
| <p>3. Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë tekste të llojeve të ndryshme letrare e joletrare, si: <i>poezi prozë, dramë etj.</i></li> <li>• Të lexojë me kuptim, qartë dhe me shqiptim të saktë me qëllim përmiresimin e shprehive të të lexuarit.</li> <li>• Të dallojë përdorimin dhe funksionin e figurave bazë letrare: <i>apostrofi, paralelizmi figurativ, metonimia, vargëzimi.</i></li> <li>• Të zbulojë karakteret e personazheve duke provuar të bëjë edhe analiza psikologjike të tyre.</li> <li>• Të zbërthejë figurat letrare duke treguar funksionin shprehës të tyre.</li> <li>• Të kometojë përmes analizave të tekstit fragmente të ndryshme.</li> <li>• Të vlerësojë idetë dhe mesazhet që percjell teksti.</li> <li>•</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vepra të letërsisë shqiptare dhe të letërsisë botërore, <i>poezi prozë, dramë</i> të kohërave të ndryshme dhe të përshtashme për këtë moshë.</li> <li>• Paraqitja e figurave bazë letrare: <i>apostrofi, paralelizmi figurativ, metonimia, vargëzimi.</i></li> </ul> |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>4. Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare</p>                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> <li>• Të grupojë pjesët që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare.</li> <li>• Të shpjegojë ndryshimet mes llojeve dhe gjinive letrare duke u mbështetur në veçoritë kompozicionale dhe gjuhësor.</li> <li>• Të realizojë analizën stilistikore të teksteve të ndryshme letrare.</li> <li>• Të bëjë vlerësimin e mjeteve gjuhësore në rrafshin leksikor.</li> <li>• Të përdorë mimikën, gjestet, intonacionin gjatë leximit.</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> <li>• Tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme.</li> <li>• Tekste të tipit informativ për të bërë krahasime me tekste të tipit letrar.</li> <li>• Tekste origjinale dhe të përshtatura që nxisin krahasim dhe mendimin kritik (Kadare, Shekspiri, Fishta, Serventesi etj)</li> <li>• Tekste letrare për të dalluar elementet e formës.</li> <li>• Realizimi i detyrave për leximet jashtë klase.</li> </ul>                                     |
| <p>5. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje</p>                    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë me zë të lartë, drejt dhe me intonacionin e duhur.</li> <li>• Të interpretojë pjesë letrare të llojeve të ndryshme.</li> <li>• Të mësojë përmendësh pjesë në poezi dhe në prozë.</li> <li>• Të interpretojë sipas vlerave poetike dhe nivelit artistik trupëzuar në prozë tekste të mësuara përmendësh duke patur parasysh: përmbajtjen e pjesës, thelbin e pjesës, zbatimin e diksionit, theksave, pauzave.</li> <li>• Të dramatizojë histori të ndryshme epiko lirike.</li> <li>• Të shndërrojë në ligjëratë të zëshme atë që është shkruar.</li> <li>• Të marrë pjesë në dramatizime të pjesëve të ndryshme.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesë të regjistruara.</li> <li>• Tekste dramatike që janë të mundshme për t'u dramatizuar dhe për t'u luajtur sipas roleve nga nxënësit.</li> <li>• Interpretim i veprave të shquara të letërisë shqipe dhe botërore.</li> <li>• Pjesë të regjistruara sipas një rendi kronologjik përmes figurave, fotografive nga filma të xhiruar e të njohur ekranizime të veprave të spikatura shqiptare dhe botërore) në jetën artistike shqiptare.</li> </ul> |
| <p>6. Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të respektojë gjatë të lexuarit rregullat e drejtshqiptimit të strukturave morfologjike dhe sintaksore.</li> <li>• Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja të fushave të veprimtarisë sipas tematikës së dhënë nga</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Terma që do t'i shtohen analizave të nxënësve në lidhje me tekstet që lexojnë, si: tema, motivet, idetë, karakteret, esazhi, vendosja e marrëdhënieve, plani i pjesës, konflikti, subjekti, kompozicioni.</li> </ul>  |

|        |  |   |
|--------|--|---|
| shqipe | <p>pjesët që lexohen.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë fjalorë për shpjegimin e fjalëve të vështira dhe të panjohura.</li> <li>• Të krijojë skedarin e librave që lexon.</li> <li>• Të përdorë bibliotekën dhe internetin.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Terma të tjera të reja, si: faktet, debati, mendimet, mendimi sintezë, dekor, skenografi, formë, opinioni.</li> <li>• Figurat letrare që dalin në këtë program për herë të parë: apostrofi, metonimia, paralelizmi figurativ, vargëzimi.</li> <li>• Materiale të fushave të ndryshme.</li> </ul> |
|--------|--|---|

### LINJA3: Të shkruarit

| Nënlinjat                 | Objektivat  | Përmbajtja   |
|---------------------------|---|--|
| 1.Të shkruarit funksional | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë për përvojat e tij.</li> <li>• Të shkruajë shumëllojshmëri modelesh (plane pune, kujtime, përshkrime, përmbledhje etj) duke organizuar saktë strukturën; hyrje, zhvillim, mbyllje</li> <li>• Të shkruajë për një gjerësi lexuesish: <i>për mësuesin, për prindërit, për shokët, për gazetat e klasës dhe të shkollës, për komunitetin, botime periodike të moshës..</i></li> <li>• Të shkruajë për të mbajtur qëndrime dhe për të dhënë informacione dhe vlerësime përmes reflektimit ndaj çështjeve për të cilat shkruan.</li> <li>• Të përdorë parashkrimin.</li> <li>• Të përdorë skicimin.</li> <li>• Të shkruajë për të dhënë informacion për të tjerët nëpërmjet përshkrimit dhe argumentimit.</li> <li>• Të shprehë me shkrim ide interesante ku të shprehë e të respektojë parimin e kronologjisë,në kronika të thjeshta me temë nga jeta moshore..</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lloje dhe modele të shkruari, si:<br/><i>plan pune, kujtime, histori të shkurtra, përshkrime veprimtarish, kronikë përmbledhje, reportazh etj.</i></li> </ul> |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>2. Të shkruarit për nevoja vetjake</p>        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zhvillojë stilin e tij vetjak të të shkruarit nëpërmjet përdorimit të shenjave dhe të strukturave të caktuara e standardeve të gjuhës.</li> <li>• Të shkruajë duke përdorur imagjinatën e tij.</li> <li>• Të shkruajë shkrime personale, si: <i>autobiografi, ditar, intervista, biografi etj.</i></li> <li>• Të shkruajë në mënyrë estetike me ndjenjë dhe me imagjinatë.</li> <li>• Të shkruajë duke përdorur analizën, krahasimin, përgjithësimin nëpërmjet përpunimit e thellimit sipas këndvështrimit vetjak.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Forma të tilla të shkruari, si: <i>letrat formale dhe personale, shënime, ditar, tregim, përshkrim, poezi, autobiografi, biografi, intervistë.</i></li> <li>• <i>Shkrime të modeleve të ndryshme.</i></li> </ul>  |
| <p>3. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë duke përdorur imagjinatën e tij.</li> <li>• Të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë me fjalor argumentues</li> <li>• Të argumentojë rreth figurave të tilla, si: <i>alienët, dinozaurët, dukuritë natyrore dhe zbulimet e shkencës e të teknikës, personazhe të shpirëzuar .</i></li> <li>• Të hartojë zgjidhje me shkrim.</li> <li>• Të gjejë mbyllje tregimesh sipas imagjinatës së tij të ndryshme nga varianti i dhënë.</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Histori të reja nga bota.</li> <li>• hkrime shkencore.</li> <li>• Skeda vëzhgimesh.</li> <li>• Pyetësorë.</li> <li>• Përvoja vetjake të veçanta .</li> <li>• Tregime romane fantastiko-shkencore, përralla, fabula.</li> <li>• Shkrime për hapësira reale dhe joreale të shfaqura në TV, video, radio etj.</li> </ul> |
| <p>4. Njohuri rreth gjuhës</p>                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të respektojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të modelit të shkrimit.</li> <li>• Të respektojë tekstin si kërkesë e rëndësishme për të shprehur mendim të përafërt.</li> <li>• Të përdorë shenjat e pikësimit sipas intonacionit të thënies.</li> </ul>  | <p>Terminologji gjuhësore, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Titulli,</li> <li>• Teksti</li> <li>• Lidhëzat,</li> <li>• Struktura e fjalisë (fjalja e thjeshtë tip, fjalja e përbërë.</li> <li>• Shenjat e pikësimit,</li> <li>• Hyrja, zhvillimi, mbyllja</li> </ul>   |

|  |  |  |
|--|--|--|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të qortojë shkrimin e vet dhe të shokut.</li> <li>• Të dallojë shenjat e pikësimit që përdoren në një tekst.</li> </ul> |  |
|--|--|--|

#### LINJA 4. Njohuri rreth gjuhës dhe sistemit të saj gramatikor

| Nënlinjat       | Objektivat  | Përmbajtja  |
|-----------------|---|---|
| <b>Sintaksë</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shpjegojë strukturën e fjalisë së thjeshtë-tip në gjuhën shqipe.</li> <li>• Të dallojë funksionet gramatikore të fjalëve në fjali.</li> <li>• Të përcaktojë funksionet gramatikore brenda grupit emëror.</li> <li>• Të dallojë grupin emëror kryefjalë si temë të fjalisë</li> <li>• Të dallojë përbërësit e grupit foljor.</li> <li>• Të dallojë grupin foljor si kallëzues të grupit emëror kryefjalë.</li> <li>• Të përcaktojë mënyrat e shprehjes së përcaktorit.</li> <li>• Të dallojë ndajshimin.</li> <li>• Të dallojë kallëzuesorin dhe llojet e tij.</li> <li>• Të gjejë dhe të shpjegojë karakteristikat e përgjithshme kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë.</li> <li>• Të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e vendit dhe të kohës</li> <li>• Të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e shkakut e të qëllimit.</li> <li>• Të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e mënyrës e të sasisë.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalë në gjuhën amtare.</li> <li>• Grupet funksionale brenda fjalisë së thjeshtë.</li> <li>• Funksionet gramatikore brenda grupit emëror.</li> <li>• Grupi emëror kryefjalë si temë të fjalisë</li> <li>• Përbërësit e grupit foljor.</li> <li>• Grupin foljor si kallëzues të grupit emëror kryefjalë.</li> <li>• Përcaktori, mënyrat e shprehjes.</li> <li>• Ndajshimi</li> <li>• Kallëzuesori i kryefjalës,</li> <li>• Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë.</li> <li>• Rrethanori i vendit dhe i kohës.</li> <li>• Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit.</li> <li>• Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë.</li> </ul> |

|                          |  |  |
|--------------------------|--|--|
| <p><b>Morfologji</b></p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë klasat e fjalëve.</li> <li>• Të klasifikojë fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.</li> <li>• Të analizojë emrin në kategoritë e tij gramatikore.</li> <li>• Te dalloje emrat me prejardhje. foljore, mbiemërore, përemërore</li> <li>• Të dallojë emrat e nyjshëm të tipit , i ati ,e motra etj.</li> <li>• Të dallojë emrat e prejardhur dhe mjetin fjalëformues.</li> <li>• Të dallojë mbiemrin dhe veçoritë e tij gramatikore.</li> <li>• Të dallojë veçoritë morfologjike të mbiemrave që shprehin cilësi.</li> <li>• Të analizojë foljen.</li> <li>• Të zgjedhë foljen në mënyrat dhe kohët e saj.</li> <li>• Të dallojë mënyrat e foljes.</li> <li>• Të zgjedhë foljet në mënyrën dëftore dhe kohët e saj.</li> <li>• Të zgjedhë foljen në mënyrën lidhore dhe kohët e saj.</li> <li>• Të zgjedhë foljen në mënyrën kushtore dhe kohët e saj.</li> <li>• Të zgjedhë foljen në mënyrën habitore dhe kohët e saj.</li> <li>• Të zgjedhë foljen në mënyrën dëshirore dhe kohët e saj.</li> <li>• Të dallojë dhe klasifikojë lidhëzat sipas llojeve grupimeve të tyre.</li> <li>• Të dallojë foljet njëvetore dhe pavetore.</li> </ul> <p>Të dallojë dhe të përdorë llojet e numërorëve</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klasat e fjalëve</li> <li>• Klasifikimi, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.</li> <li>• <b>Emri</b></li> <li>• Veçoritë gramatikore, emri nga pikëpamja fjalëformuese, emrat prejpjesor dhe grupet leksiko- gramatikore të emrit .</li> </ul> <p><b>Mbiemri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshtatja me emrin në gjini, numër e rasë.</li> <li>• Mbiemrat cilesorë dhe marrëdhënore</li> <li>• Mbiemri epitet</li> </ul> <p><b>Folja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Forma veprare e joveprare.</li> <li>• Zgjedhimi i foljes.</li> <li>• <b>Grupi foljor</b></li> <li>• <i>Mënyrat e foljes</i></li> <li>• Mënyra dëftore, vlerat kohore të së tashmes</li> <li>• Mënyra lidhore, kohët.</li> <li>• Mënyra kushtore, kohët.</li> <li>• Mënyra habitore, kohët.</li> <li>• Mënyra dëshirore, kohët</li> <li>• Foljet njëvetore dhe pavetore.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numërori dhe thyesat. Veçoritë gramatikore</li> </ul> |
|--------------------------|--|--|

|                         |  |  |
|-------------------------|--|--|
| <b>Leksikologji</b>     | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjejë fjalë të përngjitura dhe të dallojë pjesët përbërëse.</li> <li>• Të krijojë familje fjalësh.</li> <li>• Të analizojë fjalën sipas përbërësve të saj fjalëformues.</li> <li>• Të dallojë parashtesat dhe prapashtesat dhe të krijojë fjalë të prejardhura prej tyre.</li> <li>• Të krijojë fjalë të përbëra.</li> <li>• Të njohë etimologjinë si shkencë gjuhësore.</li> <li>• Të dallojë etimologjinë shkencore nga ajo popullore.</li> <li>• Të njohë fushat kuptimore të fjalëve.</li> <li>• Të dallojë frazeologjinë nga fjalët e urta dhe fjalia e thjeshtë .</li> <li>• Të dallojë fjalët me ngjyrim emocional në një kontekst të caktuar.</li> <li>• Të njohë dhe të përdorë rregjistrat e gjuhës</li> <li>• Të gjejë dhe të dallojë fjalë me ngjyrim emocional si epitete metafora etj.</li> <li>• Të dallojë kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalëformim</li> <li>• Familja e fjalëve <ul style="list-style-type: none"> <li>• Etimologjia, prejardhja e fjalëve. Etimologjia shkencore dhe ajo popullore.</li> <li>• Frazologjia, dhe fjalë të urta. Dallimet kuptimore.</li> <li>• Fjalët me ngjyrim emocional, dhe konteksti.</li> <li>• Fushat kuptimore dhe shumëkuptimësia.</li> </ul> </li> </ul> |
| <b>Kulturë e gjuhës</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë dhe të përdorë regjistrat e gjuhës për interesa mësimore dhe jo mësimore.</li> <li>• Të përcaktojë stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare.</li> <li>• Të njohë prejardhjen e toponimeve.</li> <li>• Të dallojë fjalën shqipe nga fjala e huaj.</li> </ul> <p>Të dallojë fjalën e huaj që është bërë pjesë e leksikut nga fjalët e huaja që kanë fjalën përkatëse në gjuhën tonë.</p>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregjistrat.</li> <li>• Stilet e gjuhës.</li> <li>• Toponimet dhe prejardhja e tyre.</li> <li>• Gjuha standarde shqipe</li> </ul>   |

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p><b>Drejsht-qiptim, drejtshkrim pikësim</b></p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë drejt zanoren e të theksuar në trup të fjalës.</li> <li>• Të shkruajë drejt zanoren <b>ë</b> në trup të fjalës.</li> <li>• Të shkruajë drejt emrat që mbarojnë me –ër,-ërr,-ël në shumës.</li> <li>• Të shkruajë drejt mbiemrat që mbarojnë me –ër,-ërr,-ël në shumës.</li> <li>• Të shkruajë drejt emrat që kanë dy trajta shumësi sipas kuptimit të ndryshëm të tyre.</li> <li>• Të shkruajë drejt nyjen e përparme tek përcaktorët emra.</li> <li>• Të shkruajë drejt fjalët e prejardhura me prapashtesat -si,-ri,-ar,-tar,-tor,-shëm,-të.</li> <li>• Të shkruajë drejt fjalët e përbëra kur fjala e dytë fillon me zanore.</li> <li>• Të shkruajë drejt datën duke përdorur variantin e duhur.</li> <li>• Të përdorë drejt shkronjën e madhe në ligjeratën e drejtë</li> </ul><br><ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë drejt pikëçuditësen në llojet e ndryshme të fjalive.</li> <li>• Të përdorë tripikëshin kur intonacioni i fjalisë është i pa mbaruar.</li> <li>• Të përdorë drejt presjen në fjalinë e thjeshtë</li> </ul> <p>Të përdorë drejt presjen në fjalinë e përbërë</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i zanores e të theksuar para –m,-n, -nj.</li> <li>• Drejtshkrimi i zanores <b>ë</b> në fjalët që në dialektin e Veriut kanë <b>a</b> hundore</li> <li>• Drejtëshkrimi i emrave që mbarojnë me –ër,-ërr,-ël në shumës.</li> <li>• Drejtëshkrimi i mbiemrave që mbarojnë me -ër.-ërr.-ël.në shumës. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi sipas kuptimit të ndryshëm të tyre.</li> <li>• Drejtshkrimi i nyjes së përparme në grupet emërore me përcaktorë emrat. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura me prapashtesat –si,-ri,-ar,-tar,-tor.</li> <li>• Drejtshkrimi i fjalëve të përbera ku fjala e dytë fillon me zanore .</li> </ul> </li> <li>• Drejtshkrimi i fjalëve të formuara me prapashtesën –shëm,--të.</li> </ul> </li> <li>• Drejtshkrimi i datave.</li> <li>• Përdorimi i shkronjës së madhe.</li> </ul><br><ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i (!) në llojet e ndryshme të fjalive.</li> <li>• Përdorimi i tripikëshit.</li> <li>• Përdorimi i presjes në fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë</li> </ul> |
|---|--|---|



## V. TABELA PËRMBLEDHËSE E SHPËRNDARJES SË ORËVE

| Nr   | Linjat                               | %        | Nr i orëve | Nënlinjat  |  | orë       |
|--|--------------------------------------|----------|------------|------------|--|-----------|
| <b>I</b>   | <b>Të dëgjuarit &amp; të folurit</b> | <b>8</b> | <b>15</b>  | <b>1</b>   | Për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime mënyrë individuale dhe në grup  | <b>3</b>  |
| Në praktikën e përditshme mësimore të gjitha orët e lëndës së gjuhës amtare kanë të integruar punën e planifikuar me të folurit dhe të dëgjuarit. Edhe pse janë shënuar 8% në tabelë, faktikisht në strukturën e zbatuar programore kjo linjë duhet të zërë dhe faktikisht zë 30 % të programit për vetë karakterin specifik të lëndës.  |                                      |          |            | <b>2</b>   | Në grup dhe në publik me shumëllojshmëri qëllimesh.  | <b>3</b>  |
|  |                                      |          |            | <b>3</b>   | Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme   | <b>3</b>  |
|  |                                      |          |            | <b>4</b>   | Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare   | <b>3</b>  |
|  |                                      |          |            | <b>5</b>   | Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde  | <b>3</b>  |
|  |                                      |          |            | <b>II</b>  | <b>Të lexuarit</b>   | <b>30</b> |
| Po kështu edhe për linjën e të lexuarit, është respektuar ndarja e orëve të të lexuarit në strukturë, ku zë 30% të kohës mësimore, por kjo % rritet në të vërtetë, sepse edhe në linjat e tjera të lexuarit jo vetëm që nuk mund të mos integrohet por ne e dimë se është element i gjithëpranishëm në tërë procesin mësimor. Nga cilësia e të lexuarit, nga niveli i kuptimshmërisë së të lexuarit varet jo vetëm horizonti i nxënësve, por edhe gjendja emocionale e tij. Një fëmijë që nuk kupton atë që lexon është fëmijë i palumtur. |                                      |          |            | <b>2</b>   | Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate, që të zgjerojë e të pasurojë botën e tij shpirtërore         | <b>20</b> |
|  |                                      |          |            | <b>3</b>   | Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare  | <b>18</b> |
|  |                                      |          |            | <b>4</b>   | Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare, të njohë ndarjet dhe nën ndarjet kryesore të letërsisë nga ana. normale dhe përmbajtësore. | <b>18</b> |
|  |                                      |          |            | <b>5</b>   | Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje.   | <b>4</b>  |
|  |                                      |          |            | <b>6</b>   | Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.   | <b>2</b>  |
|  |                                      |          |            | <b>III</b> | <b>Të shkruarit</b>  | <b>15</b> |
| Për vetë rëndësinë që kjo linjë ka në praktikën mësimore dhe më gjerë, në jetën e përditshme të secilit nxënës edhe pse në   |                                      |          |            | <b>2</b>   | Të shkruarit për nevoja vetjake, të përdorë atë për shumëllojshmëri qëllimesh  | <b>6</b>  |

|  |  |              |           |   |   |           |
|--|--|--------------|-----------|---|---|-----------|
| tabelën III paraqitet me 15% dmth 26 orë, faktikisht në strukturën lëndore vjetore zë dyfishin e tyre. Të shkruarit ka 30% të sasisë së orëve dmth 52 orë.   |  |              |           | <b>3</b>  | Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë, të shkruarit në mënyrë të strukturuar.        | <b>7</b>  |
|  |  |              |           | <b>4</b>  | Të shkruajë për një numër lexuesish duke praktikuar njohuritë rreth gjuhës standarde, | <b>5</b>  |
| <b>IV</b>  | <b>Njohuri rreth sistemit gjuhësor</b> | <b>30</b>    | <b>42</b> | <b>1</b>  | Sintaksë  | <b>11</b> |
| Edhe për linjën e tabelës IV do të funksionijë e njëjta logjikë, sepse është e vërtetë që njohuritë rreth sistemit gjuhësor zënë 30% të orëve të programit mësimor, por është gjithashtu e vërtetë që në linjat e tjera; të folurit, të lexuarit, të shkruarit nuk mund të mos integrohen njohuri gjuhësore. Ato njohuri janë vendosur në fund të linjave të tjera si nënlinjë më vete por është e pranishme organikisht në mënyrë të pandashme brenda tyre. |  |              |           | <b>2</b>  | Morfologji  | <b>11</b> |
|  |  |              |           | <b>3</b>  | Leksikologji  | <b>4</b>  |
|  |  |              |           | <b>4</b>  | Kulturë gjuhe   | <b>4</b>  |
|  |  |              |           | <b>5</b>  | Drejtshqiptim, drejtshkrim, pikësim   | <b>12</b> |
| <b>V</b>   | <b>Dispozicion</b>                     | <b>15 %</b>  |           | Orët do të përdoren nga mësuesi, ku ai ta shohë të nevojshme gjatë praktikës së përditshme mësimore |   | <b>26</b> |
|  | <b>GJITHSEJ</b>                        | <b>100 %</b> |           | <b>175 orë</b>  |   |           |

### Zbatimi i kurrikulës së lirë

Qëllimi i Orëve të lira ( 15% e orëve totale ) është t'i lërë hapësirat e nevojshme inisiativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministri e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive arsimore që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimit.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm , sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël, sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Dejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t' shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të përgjithshme të lëndës gjuha amtare si lëndë formuese, edukimin e tij global, si një ndërlëndë rrezatimi i rezultateve të së cilës kushtëzon mbarëvajtjen e nxënësve në lëndët e tjera të sistemit kurrikular dhe ekstrkurrikular.

Grumbullimi, sjellja në klasë dhe përdorimi i materialeve të ndryshme nga fusha të ndryshme të veprimtarisë intelektuale dhe praktike të nerëzimit, materiale letrare dhe joletrare, grafikë, diagrame, matriale nga media e shkruar dhe vizive, interneti, arkeologjia, astronomia, ekologjia, shëndeti i fëmijës, lojra të ndryshme të popujve të ndryshëm, edukimi qytetar, fjalorth të specializuar për fusha që paraqesin interes për moshën etj, mund të kthehen në burme të vlefshme për të organizuar orë mësimore “pa mure” që janë interesante dhe bëhen promotorë edhe të zgjedhjeve afatgjata të nxënësve në jetë.

Organizimi i veprimtarive në natyrë jashtë mureve të shkollës duke shfrytëzuar kushte të mjedisit në të cilin është shkolla, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në Biblioteka, teatro, muze, shtëpi muze shkrimtarësh, thjesht vende me bukuri natyrore të spikatur të vendit tonë, pra vende dhe qendra të rëndësishme për kulturën shqiptare për historinë e kombit që kanë ndikuar fuqishëm në identitetin kulturor kombëtar, të shoqëruara me vrojtime dhe me detyra në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit. Kështu mund të bëhet;

- Organizimi i konkurseve të fjalës artistike,
- Organizimi i konkurseve “Lexuesi më i mirë,,
- Organizimi i konkurseve “ veprimtaria më e mirë në shërbim të ruajtjes së mjedisit,,
- Organizimi i lojrave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesmarrëse që fuqizojnë të nxënët edhe zhdërvjelltësojnë procesin e mësimdhënies, që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik,
- Përforcimi i njohurive përmes improvizimeve të dramatizuara apo lojës me role,
- Organizimi i konkurseve për dramatizimin më origjinal,
- Shkëmbim letrash me qëllim përforcimin e njohurive të marra në kapitullin e punës me shkrim të shoqëruara me metoda dhe strategji që fuqizojnë si mësimdhënien ashtu edhe të nxënët duke luajtur.
- Organizimi i konkursit “Shkrimi më i bukur,,
- Intervista më interesante në bashkëpunim edhe me prindërit për përvoja të përbashkëta edhe pse në kohë të ndryshme.
- Përralla nga krahina prej së cilës janë.

- Ekspedita folklorike, areologjike dhe raporti i mi i punës me shkrim.

Këto janë disa veprimtaritë rekomandues që sugjerohen të zhvillohen nga mësuesi në kuadrin e orëve që ai ka në rubrikën e orëve të lira në dispozicion.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve, rritjen e efektshmërisë së kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh (në formën e një projekti ose të një teme komplekse) për të programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që shfrytëzojnë lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspekte kroskurrikulare. Nxënësve u jepet detyra që përfshijnë njohuri ndërlëndore dhe u shërben arritjes së objektivave të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duke iu gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira. Kjo do të mundësohet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashtrajnë veçoritë vendore.

Realizimi i sugjerimeve të mesipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë, të cilat jo vetëm që nuk shënojnë risi, por ia humbin karakterin inovativ kësaj rubrike në kurrikulën shkollë.

## **VI.INTEGRIMI si kriter bazë**

- Programi i gjuhës amtare është ndërtuar në mënyrë të integruar, sepse lidhja dhe integrimi i kësaj lënde me shumë komponentë të lëndëve të tjera që përfshin plani mësimor i klasës VIII, i jep kësaj disipline më shumë frymëmarrje dhe zhvillim.

Lënda e Gjuhës Amtare është bazuar në integrimin e ndërlëndor që do të thotë se në zbauesit e këtij programi duhet të:

- të realizojë parimin e integritit natyreshëm të njohurive bazë nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes, dhe mes fushave të tjera të dijeve, të tilla si: arti i fjalës, , historia, gjeografia, matematika, teknologjia, edukata qytetare, ruajtja e mjedisit, etj.
- Lidhjet integruese janë vendosur që në program për të vijuar në procesin e mësimdhënies.
- Integrimi apo bashkëveprimi i vazhdueshëm i shprehive bazë komunikuese është një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij procesi integrues.
- Ndërthurje integrale e linjave dhe nënlinjave brenda orëve ku nuk mund të ketë asnjëherë ndarje të plota mes komponentëve të programit pasi ato tëra këto rrjedhin nga njëra-tjetra dhe zhvillohen së bashku.

- Të respektojë parimin e integritimit mes linjave që e përbëjnë atë: **të folurit të lexuarit të shkruarit** dhe njohuri bazë nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes, si dhe mes fushave të tjera të dijeve, të tilla si: matematika, fizika dhe zbatime të ligjeve të tze në jetën e përditshme, historia, gjeografia, arti, ekomjedisi, edukimi ligjor, etj
- Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre shprehive forcon cilësinë e të nxënësve.
- Për të realizuar integrimin, është e nevojshme që teksti të prezantohet me njësi mësimore dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore.
- Parimi tematik mundëson realizimin e integruar të këtij programi.
- Për realizimin e integritimit edhe në momente të caktuara brenda çdo teme mësimi zbatuesit e programit duhet të shoqërojnë mësimdhënien rubrikat të pasura, të cilat synojnë integrimin, nxisin mendimin kritik, krijojnë mundësi për analizë dhe sintezë.
- Rimarrja si një parim didaktik duhet të jetë pjesë e mësimëve që do të përbëjnë këtë tekst, me qëllim lidhjen dhe përfundimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.
- Kërkohet, që përmes aftësimit praktik dhe ushtrimeve që do ta shoqërojnë atë, të arrihet në një mësimdhënie ku nxënësi **kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon, sintetizon, vlerëson.**
- Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla **si të lexuarit, të folurit, të shkruarit**, kërkohet të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimi, si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike.
- Punët me shkrim të tipit **ese, shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruarit**, kërkohet të jenë të shpeshta, veprimtari këto që i përfshijnë nxënësit në aktivitete të gjera gjithëpërfshirëse, kërkimore dhe aplikative.
- Punët me shkrim dhe ato që lidhen me modelimin e shkrimit në temat e mësimin në nuk duhet të zhvillohen vetëm në orët e planifikuara për to në program. Puna me shkrim dhe teknikat ndihmëse bashkëkohore që ndihmojnë rritjen cilësore të të shkruarit do të jenë të pranishëm gjatë të gjithë orëve.
- Kërkohet të bëhet kujdes në respektimin e raporteve midis pjesës teorike dhe asaj praktike të tij, të cilat duhet të respektojnë: 60%-40%, në favor të pjesës zbatuese.
- Kërkohet ora e mësimin të pasurohet me praktika pune si: **tabela, diagrama, grafike, foto dhe skica** të tjera, kur janë të nevojshme dhe të nxiten nxënësit t'i praktikojnë ato.
- Të prezantojnë me njësi mësimore dhe me linja të caktuara zbatuesit e programit që të mund të realizojnë integrimin dhe synime të larmishme mësimore.
- të zbatohet integrimi në program përmes respektimit të larmisë tematike.

## VII. VLERËSIMI

- \* Vlerësimi i nxënësve është një proces (pasi ka të bëjë me punën e një periudhe) me rëndësi për mësimin e gjuhës amtare në shkollë.
- \* Njohja, përshtatja dhe përdorimi i formave të reja të vlerësimit është një kërkesë e vazhdueshme që duhet të pasurohet vazhdimisht me forma pune të frytshme dhe që duhet të kihet parasysh në aparatet pedagogjike.
- \* Puna me standardet të mundësojë për një përmbajtje cilësore të kurrikulës shkollore.
- \* Praktika e përdorimit të testit mësimor është një tjetër formë vlerësimi (hartimi i testit të bëhet sipas strukturës), e cila tashmë ka një kuptim të qartë si nga mësuesi ashtu edhe nga nxënësit.

Një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit të lëndës gjuhë amtare është vlerësimi i njohurive të nxënësve. Ky proces shënon përgjegjësi të rëndësishme dhe sigurisht kërkon agjornim me parametrat bashkëkohorë.:

*Synimet e vlerësimit janë:*

- Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm mbi nivelin e njohurive, motivimin e tyre drejt të mësuarit duke përcaktuar mundësitë e tyre reale për nxënie.
- Shkallja e realizimit të objektivave të përcaktuara në programin mësimor.
- Nxitjen e interesit të nxënësit për ngritjen e nivelit të arritjeve të tyre.

*Komponentet e vlerësimit janë:*

- Vlerësim i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim.
- Për vetë natyrën e lëndës dhe rëndësinë e madhe të vlerësimit të aftësive komunikuese vlerësimi i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim është imperativ i punës së përditshme mësimore në këtë lëndë. Në dobi të nivelit të punës vlerësuese është pa dyshim vendosja e kriterëve vlerësues, njëhja e standardeve, të cilat janë në fakt, piketa të përcaktuara profesionalisht si rezultate të pritshme që duam të arrijmë, vlerësimi i nxënësit dhe nivelin e punës së bërë sipas standardeve të arritjes.

*Nëse do të nisemi nga qëllimi i realizimit të vlerësimit atëherë do të vërejmë se vlerësimin mund ta klasifikojmë në:*

- Vlerësim formues  
Realizohet kur synojmë marrjen e informacionit mbi atë që ka arritur të bëhet pjesë e formimit të tij sipas objektivave të caktuara. Këtë indikator formimi mësuesi e përdor për të ndërhyrë dhe ndryshuar gjendjen përmes një mësimdhënieje më efektive dhe kalimin në objektiva të reja; minimalë apo të nivelit më të lartë. Dihet se konceptet gjuhësore janë të lidhura dhe suksesi i objektivit varet nga shkalla e përvetësimit të atij pasardhës.
- Vlerësim diagnostikues  
Për të gjykuar dhe marrë informacion për përgatitjen ditore të nxënësit dhe shkallën e përvetësimit të materialit të ri mësimor. Vlerësimi diagnostikues jep informacion mbi efektshmërinë e të nxënës dhe ndihmon për ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies.

- Vlerësim përmbledhës  
Ky vlerësim bëhet nga mësuesi në përputhje me objektivat mësimorë në fund të mësimin të disa kapitujve, semestrit ose në fund të vitit. Informacioni nga ky lloj vlerësimi është i plotë dhe rekomandohet të bëhet jo më pak se tre herë në vit.
- Vlerësim motivues  
Qëllimi i këtij lloji vlerësimi është motivues, nxitës në drejtim të dëshirës dhe interesit të nxënësve për të mësuarit. Ndër format më efektive që rekomandohet të përdoret në shkollë është vlerësimi motivues, i cili nxit të mësuarit e nxënësve fuqishëm.

**Vlerësimi i punëve me shkrim** është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; të jenë të tilla që t'i motivojnë ata.

Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

## VIII.METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PROGRAMIT

Për leximet këshillohet të zgjidhen pjesë letrare ose jo letrare, të cilat dallohen për vlera edukuese. Kur merren nga letërsia artistike shqipe dhe ajo botërore duhet të jenë në përshtatje me psikologjinë moshore të nxënësve të klasës së tetë dhe plotësojnë kriteret e kërkesave didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës me të cilën sillen në tekstin mësimor.

Të sillen pjesë nga tradita, nga e kaluara dhe e sotmja, pjesë letrare fantastiko-shkencore për të ardhmen përmes raporteve të drejta, ku vendin kryesor ta zënë pjesët që pasqyrojnë të sotmen dhe pjesë që zhvillojnë imagjinatën për të ardhmen.

Raportet të jenë të ekuilibruara përmes të cilave të ruhet një përfaqësim sipas ndarjeve të mëposhtme. Kështu, për arsyt që i kemi shpjeguar më lart punohen më pak tekste letrare duke u lenë hapsirë më të madhe atyre joletrare. Kështu do të ketë 40% letërsi artistike e përbërë sipas shënimeve të dhëna në tabelën e **Specifikimit të linjës së të lexuarit** dhe 60% tekste joletrare që sigurisht do të përbëhen nga pjesë apo copa leximesh të shkëputura nga fusha të ndryshme të jetës, të botës femërore apo të botës së të rriturve ku edhe fëmijët bëjnë pjesë .

*Specifikimi i linjës së të lexuarit nga pikpamja e përmbajtjes letrare dhe jo letrare*

| Raporti i sugjeruar për materialin letrar dhe joletrar që do të përdoret nga nxënësi për lexime<br>(40% me 60% ) |   |            |                  |   |   |
|--|---|------------|------------------|---|---|
| Tekste letrare   |   | 26<br>orë  | Tekste joletrare | 40<br>orë   |   |
| <b><i>Të lexuarit<br/>66 orë</i></b>   | Krijimtari<br>gojore<br>artistike<br>(5 orë )                   | • Përralla | 2                | • Kronika nga ngjarje të shënuara në historinë e njerëzimit, zbulime të ndryshme gjeografike dhe hapsinore, etj.                                  | 8 |
|  |   | • Mite     | 2                | • Jetëshkrime për personalite femrash dhe burrash të shquara që kanë lënë gjurmë në fusha të ndryshme të jetës shqiptare dhe atë botërore (VIP)   | 6 |
|  |   | • Këngë    | 1                | • pjesë ku jepen qëndrime të përgjegjshme ose jo ndaj mjedisit.<br>• Pjesë që edukojnë parime qytetarie,<br>• Edukim ligjor                       | 4 |
|  | • tregime dhe fragment romani                                   |            | 5                | • Intervista me personalitete në fusha të ndryshme të jetës.  | 4 |
|  | ▪ Vjersha dhe fragment poeme                                    |            | 5                | • Kronikë nga llojet e ndryshme, të lojrave të moshës në vende të ndryshme të botës, të sportit dhe materiale të ndryshme nga olimpiadat në vite. | 6 |
|  | ▪ Fragment nga vepër dramatike                                  |            | 5                | • Grafikë arritjesh, shënime udhëtimi dhe pasqyrim i tyre në harta, harta e kryeqytetit, skema të ndryshme.                                       | 4 |
|  | • Fabula  |            | 2                | • Ditarë, plan pune, matrica  | 4 |
|  | • Ese nga mjeshtra të esesë në letërsinë botërore dhe shqiptare |            | 4                | • Kronika të ndryshme nga media e shkruar<br>• Guida për zona arkeologjike në Shqipëri ose në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.                   | 4 |



Pjesët që punohen për lexim mund të jenë me përmbajtje nga e kaluara ose me përmbajtje nga e sotmja, por detyrimisht do të kihet parasysh që të ketë prioritet pasqyrimi i veprimtarisë jetësore nga fusha të larmishme të aktivitetit njerëzor, pa harruar edhe pjesë me aventurat e “bëmat” e fëmijëve dhe të adoleshentëve në ditët tona, apo pjesë që lidhen me të drejtat e fëmijëve, me angazhimet e tyre në veprimtari të ndryshme qytetare etj.

Nuk duhet harruar se duhet të punohen edhe pjesë që zhvillojnë fantazinë dhe imagjinatën e nxënësve për të ardhmen në fusha të ndryshme të veprimtarisë jetësore të fëmijëve dhe të adoleshentëve në ditët tona: **kozmosi, fantashkenca, informacioni, mjedisi etj.**

*Letërsia shqipe me letërsinë e huaj të përfaqësohen të integruara, ashtu si duhet të jenë. Letërsia shqipe me vlerat e saj është në mënyrë të pandashme pjesë e trashëgimisë kulturore letrare botërore.*

Brenda linjës gjen trajtim edhe puna me shkrim, ku synohet të arrihet që nxënësit të përgatisin edhe detyra me shkrim në formë referati të thjeshtë për lexime jashtë klase, orët e të cilave mësuesi do t’i vendosë në planin e tij brenda orëve me shkrim, kur të bëjë zbërthimin analitik të programit.

Figurat letrare të përfaqësohen përmes simbolit, epitetit, krahasimit, similitudës, shkallëzim figurativ e hiperbolës dhe sigurisht të dhëna në pjesë të përzgjedhura letrare duhet të jepen jo vetëm si njohuri dhe kaq. Ato duhet të përdoren nga mësuesi për të demonstruar aftësitë e mëdha të shqipes për të shprehur edhe ndjenjat më të thella, bukurinë e fjalës shqipe. Kjo kërkon që të ngulmohet te funksioni artistik i përdorimit të tyre. Madje të shkohet më tej të punohet me nxënësit t’i përdorin ato. Kjo do t’i bënte të shohin poezinë brenda tyre dhe në jetën që i rrethon, do të thotë t’i aftësosh të zbulojnë të bukurën. i **Programi i gjuhës amtare në klasën e tetë përgjithësisht mundëson dhe orienton zbatuesit e tij që:**

- të ruajë karakterin kombëtar dhe të pasqyrojë identitetin kulturor të nxënësve.
- të ndihmojë në formimin e përgjithshëm intelektual të çdo individi.
- të ndihmojë në krijimin e marrëdhënieve humane në jetën e përditshme.
- të pasqyrojë përmasat e sotme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

**Programi i gjuhës amtare në klasën e tetë shkencërisht mundëson dhe orienton zbatuesit e tij që:**

- Mësimi i gjuhës amtare të mbështetet në modelet më të mira të fjalës së dëgjuar, të folur, të lexuar e të shkruar të gjuhës që zhvillohet në procesin e vet të gjallë.
- Mësimi i gjuhës amtare të përcjellë zhvillimet e reja të gjuhës dhe të ligjeve të zhvillimit të saj.
- Njohuritë për sistemin gramatikor të gjuhës shqipe të jenë të qarta, pa mbingarkesë, dhe të kenë karakter funksional të jepen përmes shembujve të kapshëm.
- Të respektohet parimi i përfaqësimit të niveleve gjuhësore sipas specifikave që kanë.
- Parimi morfosintaksor të fillojë të respektohet atëherë kur nxënësit kanë njohje të mira për klasat e fjalëve dhe funksionet e tyre sintaksore.

**Programi i gjuhës amtare në klasën e tetë nga pikpamja didaktike mundëson dhe orienton zbatuesit e tij që:**

- Mësimi i lëndës përmes programeve dhe teksteve përkatëse të respektojë parimin e integritimit ndërlëndor.
- Në qendër të mësimit të qëndrojnë parimi i zhvillimit të mendimit kritik gjatë të lexuarit e të shkruarit.
- Mësimi i gjuhës amtare të jetë në qendër të zhvillimit dhe të përdorimit të metodave të reja të didaktikës bashkëkohore që nxënësi të jetë në qendër të procesit mësimor me të drejta të plota për pjesëmarrje me përvojat jetësore që zotëron.
- Mësimi i gjuhës amtare të lejojë mësuesin të përdorë metoda, përvojën vetjake si dhe materiale të gjetura nga burime alternative apo të krijuara prej tij në interes të përvetësimit të gjuhës amtare në shkollë.

